

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSH TJJA IBRAHIMI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesat nr. 81057/17 dhe 4 të tjera – shih listën bashkëlidhur)

VENDIM
STRASBURG
14 janar 2025

Ky vendim është përfundimtar, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Ibrahim kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Lətif Hüseyinov, *kryetar*,
Darian Pavli,
Úna Ní Raifeartaigh, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesat kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga kërkuessit e listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuessit”), në data të ndryshme të përcaktuara në atë tabelë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) e përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, mbi kërkesat e bëra në lidhje me të drejtën e kërkuessit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, si edhe me të drejtën e kërkuessit për të marrë pjesë personalisht gjatë procedurave penale ndaj tij, dhe për t’u vetëmbrojtur me anë të ndihmës juridike sipas zgjedhjes së tij në një seancë të mbajtur në Gjykatën e Lartë me kërkesën nr. 81057/17, dhe të drejtën e kompanisë kërkuessë për të marrë pjesë në procedurat e mbajtura në Gjykatën e Rrethit Tiranë në kërkesën nr. 7386/22, dhe për ta shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesave;

vërejtjet e palëve;

komentet e paraqitura nga Res Publica, të cilëve iu ishte dhënë leja për të ndërhyrë nga Kryetari i Seksionit, dhe vërejtjet e kërkuessit si përgjigje ndaj parashtrimeve të palëve të treta;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 3 dhjetor 2024,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSH TJJES

1. Çështjet në fjalë kanë të bëjnë me procedura të ndryshme të mbajtura në gjykatat vendëse, ku kërkuessit parashtronin ankesat e tyre kushtetuese ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë të miratuara në çështjet e tyre respektive. Në të gjitha çështjet, Gjykata Kushtetuese i shpallte ankesat kushtetuese të kërkuessve të papranueshme, pasi ishin paraqitur jashtë afatit prej katër muajsh, duke e nisur numërimin që prej datës kur ishin miratuar vendimet e kundërshtuara të Gjykatës së Lartë, dhe jo prej datës në të cilën kërkuessit kishin mësuar për to efektivisht.

2. Në kërkesat nr. 57542/18, 32939/21, 54121/21 dhe 7386/22, Gjykata Kushtetuese gjykonte se sa herë që një palë kërkon që t’i ofrohet vendimi, gjykata që e ka lëshuar vendimin konkret do të duhet të vendosë një vulë në vendim, dhe se kjo vulë nuk mund të shërbejë si provë vendimtare e datës në

të cilën vendimi i kundërshtuar i është dhënë fillimisht një pale. Gjykata Kushtetuese gjykante se i takonte palës që të provonte se nuk i ishte dorëzuar vendimi i kundërshtuar në një datë më të hershme.

1. Ibrahim kundër Shqipërisë, nr. 8105/17

3. Çështja ka të bëjë me procedurat penale ndaj kërkuesit gjatë të cilave ai ishte dënuar me pesëmbëdhjetë vjet burgim për vrasje. Në këto procedura, Gjykata e Lartë e ka miratuar vendimin e saj më 25 qershor 2015. Më 12 maj 2017, autoritetet e burgjeve i dorëzuan kërkuesit një letër të Gjykatës së Lartë, me anë të së cilës kërkuesi njoftohej për vendimin e saj.

4. Ankesa kushtetuese e kërkuesit e paraqitur më 5 qershor 2017, me anë të së cilës ai ankohej për shkeljen e së drejtës së tij për t'u njoftuar për një seancë pranë Gjykatës së Lartë dhe të së drejtës së tij për ndihmë juridike u shpall e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese më 16 qershor 2017, si e paraqitur jashtë afatit, duke e nisur numërimin e ditëve nga data kur ishte miratuar vendimi i Gjykatës së Lartë.

2. Selimi kundër Shqipërisë, nr. 57542/18

5. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje për pronën në të cilën kërkuesit ishin palë. Në këto procedura, Gjykata e Lartë miratoi vendimin e saj më 25 qershor 2015. Ky vendim iu dorëzua kërkuesve më 18 tetor 2017. Kërkuesit paraqitën një ankesë kushtetuese më 13 shkurt 2018. Më 30 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshme, pasi ankesa ishte dorëzuar pas përfundimit të afatit katërmujor, duke e nisur numërimin që prej datës kur ishte miratuar vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë.

3. Nika kundër Shqipërisë, nr. 32939/21

6. Çështja ka të bëjë me procedurat në gjykatat vendëse ku kërkuesja kundërshtoi shkarkimin e saj nga detyra si inspektore në Drejtorinë e Pyjeve Shkodër. Në këto procedura, Gjykata e Lartë miratoi vendimin e saj më 27 maj 2020. Ky vendim iu dorëzua kërkueses më 14 janar 2021. Kërkuesja paraqiti një ankesë kushtetuese më 18 janar 2021. Më 26 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën të papranueshme pasi ishte paraqitur jashtë afatit katërmujor, duke e nisur numërimin që prej datës kur ishte miratuar vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë.

4. Dedaj kundër Shqipërisë, nr. 54121/21

7. Çështja ka të bëjë me procedurat në gjykatat vendëse ku kërkuesja kundërshtoi shkarkimin e saj nga detyra. Në këto procedura, Gjykata e Lartë e miratoi vendimin e saj më 27 korrik 2020. Ky vendim iu dorëzua kërkueses më 1 prill 2021. Kërkuesja paraqiti një ankesë kushtetuese më 9 qershor 2021. Më 26 korrik 2021, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën të papranueshme, pasi ishte paraqitur jashtë afatit katërmujor, duke e nisur numërimin që prej datës kur ishte miratuar vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë.

5. Industri Ndërtim (IN) sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr. 7386/22

8. Çështja ka të bëjë me procedurat civile që kanë lidhje me detyrimet kontraktuale të kompanisë kërkuese. Në këto procedura, Gjykata e Lartë e miratoi vendimin e saj më 17 shkurt 2021. Ky vendim iu dorëzua kompanisë kërkuese më 4 qershor 2021. Kompania kërkuese paraqiti një ankesë kushtetuese më 29 shtator 2021. Më 29 tetor, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën të papranueshme, pasi ishte paraqitur jashtë afatit katërmujor, duke e nisur numërimin që prej datës kur ishte miratuar vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

9. Duke mbajtur në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon të përshtatshme t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

10. Gjykata vëren se ankesat e kërkuessve në lidhje me të drejtën e tyre për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese nuk janë të pambështetura në fakte, sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës apo të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

11. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate dhe, veçanërisht, për t'iu drejtuar gjykatave të larta janë përmbledhur në çështjen *Zubac kundër Kroacisë* ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76-99, 5 prill 2018).

12. Gjykata ka konstatuar më herët një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës ku afati për paraqitjen e një ankesë kushtetuese ishte llogaritur nga data kur ishte shpallur vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur i ishte dorëzuar kërkuessit (shih *Supergrav Albania Shpk kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, §§ 17-31, 9 maj 2023).

13. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese gjykonte se sa herë që një palë kërkonte që t'i dorëzohej vendimi i Gjykatës së Lartë, në këtë vendim vendosej një vulë me datën e dorëzimit. Sipas këndvështrimit të Gjykatës Kushtetuese, kjo nuk provonte se vendimi nuk i ishte dorëzuar më herët një pale. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk e sqaronte se në çfarë mënyre një palë mund të paraqiste provë pozitive për datën e njoftimit të parë (krahaso *Aždajić kundër Sllovenisë*, nr. 71872/12, § 69, 8 tetor 2015), ose përse vetëm një palë duhej të mbante barrën e provës për këtë aspekt. Gjykata gjykon se kryesisht i takon Gjykatës së Lartë të sigurojë se ka prova në dosjen e saj të çështjes për datën e dorëzimit të vendimit të saj te palët (shih, *mutatis mutandis*, *Zela kundër Shqipërisë*, nr. 33164/11, § 38, 11 qershor 2024).

14. Në mbështetje të rrethanave të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur edhe neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuessve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

III. ANKESAT E TJERA

15. Në kërkesën nr. 81057/17, kërkuessi u ankua edhe se e drejta e tij për të marrë pjesë personalisht në procedurat penale ndaj tij, dhe për të mbrojtur veten e tij me anë të ndihmës juridike, sipas zgjedhjes së tij në një seancë dëgjimore zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ishin shkelur në kundërshtim me garancitë e parashikuara në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës.

16. Në kërkesën nr. 7386/22, kompania kërkuese u ankua se ishte shkelur e drejta e saj për të marrë pjesë në procedurat e mbajtura në Gjykatën e Rrethit Tiranë, dhe përbërja e asaj gjykate nuk ishte në përputhje me ligjin, duke qenë që të dyja këto shkelje në kundërshtim me garancitë e parashikuara në nenin 6 § 1 të Konventës.

17. Gjykata ka konstatuar një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa ka të bëjë me mënyrën me anë të së cilës Gjykata Kushtetuese ka interpretuar se si afati për paraqitjen e një anekese kushtetuese i privonte kërkuessit për t'iu drejtuar gjykatës. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtonte meritat e ankesave kushtetuese të kërkuessve.

18. Duke iu referuar gjetjeve të saj në lidhje me të drejtën e kërkuessve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shih paragrafin 14 më sipër), Gjykata shprehet se kërkuessit tani kanë një mundësi që të kërkojnë rihapjen e procedurave pranë asaj gjykate. Kjo e fundit do të lejonte shqyrtimin e ankesave të mbetura të kërkuessve në mbështetje të Konventës (shih për shembull, në lidhje me mundësinë e Gjykatës Kushtetuese për t'i adresuar ankesat për gjykim të drejtë, *Muçaj kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 37814/10, § 26, 11 korrik 2023, me referenca të mëtejshme). Gjykata nuk mund të spekulojë se cili do të ishte rezultati i këtyre proceseve. Në këto rrethana, Gjykata gjykon se ankesat e mbetura të kërkuessve janë të nxituara dhe duhet të rrëzohen në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, *Baljak dhe të Tjerë kundër Kroacisë*, nr. 41295/19, §§ 45-46, 25 nëntor 2021).

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

19. Kërkuesit në kërkesat nr. 81057/17, 57542/18 dhe 54121/21 kërkonin kompensim në shuma të ndryshme për dëmin jopasuror. Kompania kërkuese në kërkesën nr. 7386/22 kërkonte 538,000 ALL për kostot dhe shpenzimet për përfaqësimin e saj në Gjykatë.

20. Qeveria i kundërshtoi këto shuma.

21. Gjykata i akordon secilit prej ankuesve në kërkesat nr. 81057/17 dhe 54121/21, dhe kërkuesve të bashkuar në kërkesën nr. 57542/18, 3,600 euro (EUR) për dëmin jopasuror plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuesve.

22. Duke mbajtur në konsideratë dokumentet në zotërimin e saj dhe praktikën e saj gjyqësore, Gjykata, e gjykon të arsyeshme që t'i akordojë kompanisë kërkuese në kërkesën nr. 7386/22, EUR 2,000 për kostot dhe shpenzimet plus çdo tarifë që mund t'i tarifohet kompanisë kërkuese.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Vendos* t'i bashkojë kërkesat;
 2. *I shpall* ankesat në lidhje me të drejtën e kërkuesve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese të pranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesave të papranueshme;
 3. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;
 4. Gjykon:
 - a) se Shteti i paditur duhet të paguajë brenda tre muajve shumat e mëposhtme të konvertuara në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;
 - i. 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro) për secilin kërkues në kërkesat nr. 81057/17 dhe 54121/21, dhe së bashku kërkuesve në kërkesën nr. 57542/18, plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jopasuror;
 - ii. 2,000 euro (dy mijë euro) për kompaninë kërkuese në kërkesën nr. 7386/22, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kompanive kërkuese, për kostot dhe shpenzimet;
 - b) se prej përfundimit të tre muajve përmendur më sipër deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barasvlershme me normën marginale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindjeje.
 5. *Rrëzon* pjesën e mbetur të kërkesës së kërkuesve për shpërblim të drejtë.
- Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 14 janar 2025, në mbështetje të rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova **Lëtif Hüseyinov**
ZËVENDESESEKRETARE KRYETAR

SHTOJCË LISTA E ÇËSHTJEVE

Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Dorëzuar më	Kërkuesi Viti i lindjes Vendbanimi Kombësia	Përfaqësuar nga
1.	81057/17	Ibrahimi kundër Shqipërisë	24.11.2017	Besnik IBRAHIMI 1971 Peqin Shqiptar	Besnik ÇEREKJA
2.	57542/18	Selimi kundër Shqipërisë	30.11.2018	Denis SELIMI 1977 Tiranë Shqiptar	

				Edit SELIMI 1968 Tiranë Shqiptar	
3.	32939/21	Nika kundër Shqipërisë	21.6.2021	Dede NIKA 1969 Shkodër shqiptar	Atmir MANI
4.	54121/21	Dedaj kundër Shqipërisë	21.10.2021	Tom DEDAJ 1963 Tiranë Shqipëri	Roland ISLAMI
5.	7386/22	Industri Ndërtim (IN) sh.p.k. kundër Shqipërisë	2.2.2022	Themeluar në vitin 1995 në Dibër, Shqipëri	Ardian KASAPI